



Advokim për njohjen dhe zbatimin e Rekomandimeve të GREVIOs për Shqipërinë Bashkia Vau i Dejës

Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë" ka zhvilluar gjatë muajit Mars 2025 aktivitete të rëndësishme në kuadër të advokimit për zbatimin e rekomandimeve të formuluar në Raportin e Parë Tematik të GREVIO-s për Shqipërinë.

Aktiviteti u realizuan në formën e një ëorkshopit, i mbajtur në sallën e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Vau i Dejës. Në të morën pjesë përfaqësues nga Ekipi Teknik Ndërdisciplinor i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, Këshilli Bashkiak, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë kyç, të cilët punojnë me viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Gjatë prezantimit të Raportit të GREVIO-s, u diskutuan rekomandimet kryesore të tij, duke u fokusuar në masat që nevojiten për zbatimin e tyre.

Të pranishmit theksuan rëndësinë e sigurisë së qëndrueshmërisë së stafit të administratës shtetërore, për të trajtuar çështjet e dhunës në familje. UPMM u vlerësua si një mjet i rëndësishëm i policisë së shtetit për vënien në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje në rrezik për jetën. Qëndrueshmëria e stafit u theksua se garanton një shërbim më cilësor ndaj viktimave të dhunës në familje.

Pjesëmarrësit diskutuan gjithashtu për dhunën kibernetike dhe rëndësinë e përmirësimit të kuadrit ligjor në këtë fushë, trajnimin e stafit të institucioneve shtetërore dhe rritjen e ndërgjegjësimit për raportimin e rasteve.

Një çështje me rëndësi ishte edhe forcimi i rolit aktiv të punonjësve të shëndetësisë në lidhje me raportimin e dhunës në familje, dokumentimin e rasteve dhe rolin e reporteve të posacme mjeksore në procesin e të provuarit.

Takimet e organizuara kanë shërbyer për një njohje të thelluar të rekomandimeve të GREVIOs për Shqipërinë dhe marrjen e masave nga cdo institucion përgjegjës në zbatim të tyre.

Kjo nismë kishte për qëllim gjithashtu rritjen e bashkëpunimit dhe forcimin e angazhimit institucional për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe përmirësimin e shërbimeve për to.

Advokimi u krye nga organizata Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë", organizatë anëtare e Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore, në kuadrin e punës për zbatimin e rekomandimeve të Grupit të Ekspertëve GREVIO për Shqipërinë, në zbatim të projektit "Fuqizimi i Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore drejt realizimit progresiv të Agjendës normative të barazisë gjinore përmes përdorimit të standardeve ndërkombëtare të Konventës CEDAW dhe Konventës së Stambollit", në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "T'i japim fund dhunës ndaj Grave" i financuar nga Qeveria e Suedisë dhe zbatuar nga tre agjencitë e UN, UN Women, UNDP dhe UNFPA.



Foto nga aktivitetet e organizuara nga Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë"